

**Presidentja Osmani
merr pjesë në themelimin
zyrtar të Bordit të Paqes
në Uashington** | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDERËT E UÇK-së PËRFUNDOJNË DEKLARATAT PËRMBYLLËSE NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

LIDERËT E UÇK-së: JEMI TË PAFAJSHËM. LUFTA E UÇK-së ISHTE E DREJTË DHE ÇLIRIMTARE

FAQE 4-5



Strategët e lirisë së Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kanë paraqitur të mërkurën deklaratat përfundimtare në procesin gjyqësor Hagë. Me plotë dinjitet dhe krenari, ata kanë mbrojtur luftën e UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Thaçi, Veseli, Selimi dhe

Krasniqi janë deklaruar tërësisht të pafajshëm. Ata kanë thënë se nuk kanë kryer asnjë krim dhe se prokuroria nuk ka mundur t'i arsyetojë akuzat kundër tyre. Katërshja e UÇK-së ka akuzuar ZPS-në se është mbështetur në narrativen e Serbisë kundër UÇK-së dhe Kosovës

AKTUALE



**MYFTIU TËRNAVA: MESAZHI
I RAMAZANIT ËSHTË PAQJA,
PASTRON ZEMRËN NGA URREJTJA
DHE NDALON FYERJEN** F. 6

**BAJRAMI: KA ARDHUR KOHA
TË NDËRROHET KUSHTETUTA
E KOSOVËS, PRESIDENTI
TË ZGJEDHET NGA POPULLI** F. 7

**BE-ja: STATUSI I INSTITUCIONEVE
ARSIMORE DHE SHËNDËTËSORE
SERBE NË KOSOVË TË ZGJIDHET NË
DIALOGUN E BRUKSELIT** F. 7


EKONOMI




**KOSOVA DHE BRITANIA
PAJTOHEN PËR BASHKËPUNIM
EKONOMIK DHE TREGTAR** F. 8

**MIRATOHET NË KOMISION
PROJEKTLIGJI PËR BUXHETIN,
OPOZITA KËRKON RITJEN E
PENSIONEVE** F. 8

SPORT



**GODITJE PËR KOSOVËN DHE
NAPOLIN, RRAHMANI DY MUAJ
JASHTË FUSHËS** F. 11



**HAXHIU NË PRITJE TË KANDIDATURAVE
PËR PRESIDENT, PARALAJMËRON THIRRJEN E
SEANCËS PAS SIGURIMIT TË NËNSHKRIMEVE** F. 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Asnjë marrëveshje për çështjet kryesore në bisedimet e Gjenevës

KIEV, 18 SHKURT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se nuk ka asnjë marrëveshje midis Ukrainës dhe Rusisë për çështjet kryesore në bisedimet e ndërmjetësuar nga ShBA-ja

në Gjenevë. “Mund të shohim se është bërë njëfarë pune bazë, por për momentin qëndrimet ndryshojnë, sepse negociatat nuk ishin të lehta”, u ka thënë presidenti ukrainas gazetarëve pas përfundimit të

bisedimeve.

Ai ka përmendur fatin e territoreve të pushtuara në lindje të Ukrainës dhe të ardhmen e termocentralit bërthamor Zaporizhzhia, të cilin Rusia e ka marrë nën

kontroll, si çështjet “e ndjeshme” të pazgjidhura në bisedimet e paqes. Të mërkurën në Gjenevë është mbajtur dita e dytë e një raundi të ri bisedimesh ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë.



STARMERI DHE TRUMPI: IRANI NUK DUHET TË ZHVILLOJË ARMË BËRTHAMORE

LONDËR, 18 SHKURT - Kryeministri britanik Keir Starmer dhe presidenti amerikan Donald Trump kanë diskutuar mbi luftën në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme si dhe bisedimet që po zhvillohen midis ShBA-së dhe Iranit.

Gjatë një telefonate, Starmeri ka përsëritur dënimin e tij për sulmet ruse ndaj civilëve në Ukrainë, ka thënë zyra e kryeministrit britanik në një deklaratë, duke shtuar se udhëheqësit diskutuan për negociatat që po zhvillohen për të siguruar paqe të drejtë dhe të qëndrueshme. Duke iu referuar situatës në Rripin e Gazës, kryeministri britanik ka reflektuar mbi situatën aktuale në rajon dhe rëndësinë e sigurimit të qasjes së mëtejshme për ndihmën humanitare.

Më 8 tetor 2023 Izraeli ka filluar luftë në Gaza, e cila ka zgjatur dy vjet, duke lënë të vrarë më

shumë se 72 mijë palestinezë të vrarë dhe 171 mijë të plagosur si dhe shkatërrimit masiv që preku 90 për qind të infrastrukturës civile, me kostot e rindërtimit të vlerësuara nga Kombet e Bashkuara në rreth 70 miliardë dollarë.

Starmeri dhe Trumpi kanë konfirmuar angazhimin e tyre të përbashkët për ta promovuar stabilitetin dhe paqen në Lindjen e Mesme, tha deklaratë. Ata kanë diskutuar edhe për bisedimet e vazhdueshme midis ShBA-së dhe Iranit që po zhvillohen në Gjenevë mbi programin bërthamor të Iranit. “Të dy ranë dakord që Irani nuk duhet të jetë kurrë në gjendje të zhvillojë armë bërthamore dhe përsëritën nevojën për të bashkëpunuar ngushtë midis aleatëve dhe partnerëve për ta përmirësuar sigurinë rajonale”, ka thënë zyra e kryeministrit britanik.



MACRONI MBRON FRANCEZËT QË LUFTUAN PËR IZRAELIN: NUK MUND T’I AKUZONI PËR GJENOCID

PARIS, 18 SHKURT - Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë se shtetasit francezë me shtetësi të dyfishtë franko-izraelite janë “fëmijë të Francës” dhe se nuk duhet kurrë t’i akuzosh ata si gjenocidale. Ai është shprehur për “Radio J”, një stacion që merret me çështjet e komunitetit hebre, duke theksuar se lufta kundër antisemitizmit është një betejë e Republikës.

Macroni ka thënë se nuk mund të pranohet që ndonjë francez të quhet gjenocidal, pasi ky



është një keqinterpretim i vlerave që Franca mbron. Duke folur për situatën aktuale, ai aludoi te disa aktivistë pro Palestinës dhe figurat e majta politike në Francë, të cilat, sipas tij, kanë përdorur debate për rastet ndërkombëtare për t’i dehumanizuar dhe stereotipizuar bashkëqytetarët hebrej.

Komentet e Macronit vijnë pasi autoritetet franceze më 3 shkurt kanë lëshuar urdhër për dy shtetas franko-izraelitë për “bashkëfajësi në gjenocid” lidhur me pretendimet se ata

tentuan ta pengonin hyrjen e ndihmave humanitare në Rripin e Gazës gjatë konfliktit atje. Urdhrat kërkojnë që personat të paraqiten para një gjyqtari hetues, por nuk parashikojnë arrestimin e tyre. Në përgjigje të Macronit, Francesca Albanese, raportuese speciale e OKB-së për Palestinën, ka kritikuar komentet e tij, duke shkruar se nuk duhet etiketuar dikush si kriminal apo gjenocidal vetëm për shkak të nacionalitetit dhe se gjykatat duhet ta vendosin këtë në bazë të fakteve.

Merzi përjashton mundësinë e pajisjes së Gjermanisë me armë bërthamore

BERLIN, 18 SHKURT - Kancelari konservator gjerman, Friedrich Merz, ka përjashtuar mundësinë që forcat e armatosura gjermane të pajisen me armë bërthamore. “Nuk dua që Gjermania të

mendojë për pajisen me arsenalin e vet bërthamor të pavarur”, ka thënë Merz. Ai ka kujtuar traktatet paraprake me të cilat Berlino është zotuar të përmbahej nga lëvizje të tilla, të quajtura marrëveshja

“2+4” që kishte hapur rrugën për ribashkimin e saj në vitin 1990 dhe Traktati i Mospërhapjes së Armëve Bërthamore. Në Konferencën e Sigurisë në Muni javën e kaluar, kancelari gjerman ka

thënë se po diskutonte me presidentin francez Emmanuel Macron për propozimin e këtij të fundit për të krijuar një kuadër evropian të parandalimit bërthamor.



PRESIDENTJA OSMANI MERR PJESË NË THEMELIMIN ZYRTAR TË BORDIT TË PAQES NË UASHINGTON



Prishtinë, 18 shkurt - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, do të marrë pjesë sot (e enjte) në ceremoninë zyrtare të themelimit të Bordit të Paqes, nismës së presidentit amerikan Donald Trump për dhënie fund konflikteve në botë. Pjesëmarrjen e Osmanit e ka konfirmuar këshilltari i saj për medie, Bekim Kupina. Vetë presidenti Trump ka bërë me dije përmes disa postimeve në rrjete sociale se ceremonia do të zhvillohet më 19 shkurt në Institutin për Paqe të Trumpit në Uashington. “Do të bëjmë me dije se vendet anëtare janë zotuar për më shumë se pesë miliardë dollarë për përpjekjet për rindërtim dhe ndihmë humanitare për Gazën, dhe janë të përkushtuara për të angazhuar mijëra trupa në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese për ta garantuar sigurinë dhe paqen për banorët e Gazës”, ka shtuar presidenti Trump. Nga Presidenca e Kosovës kanë konfirmuar më herët për “Radion Evropë e Lirë” se shtetit nuk i është kërkuar pagesa prej një miliard dollarësh. Bordi i Paqes është themeluar më 22 janar në Davos të Zvicrës, në prani të presidentit Trump. Kosova është përfaqësuar nga presidentja Osmani. Bordi i Paqes i ka 27 anëtarë. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e ka autorizuar këtë trup që ta mbikëqyrë zbatimin e armëpushimit në Gazë dhe të angazhohet në aspektin e qeverisjes dhe rindërtimit. Themelimi i Bordit është paraparë

në planin 20-pikësh të Trumpit për paqe në Gazë. Ky plan është pranuar nga Izraeli dhe Hamasi - organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e tjera, në tetor të vitit 2025, për t’iu dhënë fund luftimeve dyvjeçare.

Rëndësia e pjesëmarrjes së Kosovës në Bordin e Paqes

Profesori i studimeve për paqe dhe konflikt në Universitetin e Dublinit në Irlandë, Gëzim Visoka, i ka thënë ditë më parë Radios Evropë e Lirë se pjesëmarrja e Kosovës në këtë bord mund t’i sjellë vendit përfitime të rëndësishme në politikën e jashtme pavarësisht prej kostove të mundshme. Sipas tij, për sa kohë Kosova mbetet jashtë organizatave të mëdha ndërkombëtare si NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, nisma të tilla mund t’i shërbejnë forcimit të pozicionit të saj diplomatik. “Kjo platformë mund t’i ofrojë Kosovës një hapësirë për lobim dhe të kërkojë njohje të reja nga shtete si Maroku apo vende të tjera që ende nuk e kanë njohur Kosovën... Deri më tani sistemi i OKB-së nuk i ka ofruar Kosovës barazi, qasje të duhur, nuk ka qenë në shërbim të së drejtës së Kosovës për vetëvendosje, për anëtarësim në sistemin ndërkombëtar dhe për njohje ndërkombëtare. Në njëfarë mënyre, kjo është edhe një

protestë ndaj rendit të OKB-së, i cili ka përfunduar duke u bërë vegël e fuqive të mëdha”, ka thënë ai.

Çfarë dihet për pjesëmarrjen në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese?

Përveç Bordit, autoritetet në Kosovë kanë konfirmuar se janë në proces të shqyrtimit të formës dhe kapacitetit me të cilin do të mund të kontribuojnë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës

(FSK) në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije më herët gjatë vitit se pjesëmarrja e FSK-së në këtë forcë vjen pas pjesëmarrjes në një konferencë në Doha të Katarit në dhjetorin e vitit paraprak, të organizuar nga Komanda Qendrore e Shteteve të Bashkuara. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, i ka thënë “Radios Evropë e Lirë” se konferenca në Katar ka pasur karakter informues lidhur me Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese dhe se Kosova është ftuar të marrë pjesë nga ushtria amerikane. Hollësi për Forcën

Ndërkombëtare Stabilizuese, që ka mandat të Kombeve të Bashkuara, nuk janë bërë publike, por ajo besohet se do të ketë për detyrë ofrimin e sigurisë dhe mbikëqyrjes së armëpushimit në Rripin e Gazës. Shtëpia e Bardhë ka thënë se komandant i Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese është emëruar gjeneralmajori i ushtrisë, Jasper Jeffer, komandant amerikan i operacioneve speciale. Lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit nisi në tetor të vitit 2023, pasi Hamasi vrau mbi 1 200 njerëz në Izrael dhe mori qindra pengje. Sulmet hakmarrëse izraelite në Gazë shkaktuan mbi 60 000 njerëz të vrarë, krizë urie dhe dëme të mëdha infrastrukturore.

Rama niset drejt ShBA-së, merr pjesë në themelimin zyrtar të Bordit të Paqes me ftesë të Trumpit

Kryeministri shqiptar Edi Rama është nisur të mërkurën drejt Uashingtonit, në përgjigje të ftesës së presidentit amerikan Donald Trump për pjesëmarrje në themelimin zyrtar të Bordit të Paqes. Me këtë rast, do të fillojë edhe aktiviteti i këtij bordi, ku Shqipëria do të jetë shtetthemelues. Ditë më parë Rama është

shprehur se “Shqipëria nuk do të kontribuojë me para për t’u anëtarësuar apo për të qëndruar si anëtare e përhershme, por kontribuon me dinjitetin dhe me atë që e ka bërë të respektohet ndërkombëtarisht dhe të ftohet, deri në këtë nivel kaq të lartë të diskutimit mbi të ardhmen e paqes”.



Ambasadori i BE-së në Kosovë takohet me Haxhiun, ia përmend Kodin Civil dhe reformën gjyqësore

Prishtinë, 18 shkurt - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, është prituri të mërkurën në takim nga kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ku është bërë me dije

se përtej ratifikimit të marrëveshjeve të Planit të Rritjes, ndër prioritetet kryesore duhet të jenë Kodi Civil dhe reforma në gjyqësor. “Ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, pati

kënaqësinë të takojë sot me kryetaren e re të Kuvendit, Albulena Haxhiu. Përtej ratifikimit të marrëveshjeve të Planit të Rritjes, ai theksoi prioritetet kryesore legislative: Kodin Civil, KPM-

në, RTK-në, SEPA-n, reformën gjyqësore dhe ligjet e paketës së energjisë si pjesë e reformave që e çojnë përpara Kosovën në rrugën e saj evropiane!”, ka njoftuar Zyra e BE-së në Kosovë.





LIDERËT E UÇK-SË PËRFUNDOJNË DEKLARATAT PËRMBYLLËSE NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

LIDERËT E UÇK-së: JEMI TË PAFAJSHËM. LUFTA E UÇK-së ISHTE E DREJTË DHE ÇLIRIMTARE

Strategët e lirisë së Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kanë paraqitur të mërkurën deklaratat përfundimtare në procesin gjyqësor Hagë. Me plotë dinjitet dhe krenari, ata kanë mbrojtur luftën e UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar tërësisht të pafajshëm. Ata kanë thënë se nuk kanë kryer asnjë krim dhe se prokuroria nuk ka mundur t'i arsyetojë akuzat kundër tyre. Katërshja e UÇK-së ka akuzuar ZPS-në se është mbështetur në narrativen e Serbisë kundër UÇK-së dhe Kosovës

ajo nuk e ka obligim t'i vërtetojë akuzat ndaj të akuzuarve.

Në fund të ditës, ishte radha e liderëve të UÇK-së për t'u deklaruar përfundimisht rreth akuzave me të cilat ngarkohen. Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi, secili, veç e veç kanë ngulur këmbë në fjalët e tyre

përmbyllëse se ndihen tërësisht të pafajshëm dhe kanë mbrojtur luftën e UÇK-së, duke thënë se ajo ishte e drejtë dhe për çlirimin e një populli që po përballej me një luftë agresore. Ata kanë thënë se nuk kanë kryer asnjë krim dhe se prokuroria nuk ka mundur t'i arsyetojë akuzat, siç ka thënë, të pabazuara kundër tyre.

Pas përfundimit të deklaratave të tyre, kryegjykatësi Charles Smith III e ka shpallur të shpallur të mbyllur çështjen gjyqësore.

Smith ka bërë me dije se do të jetë në kontakt me palët në muajt në vijim lidhur me datën e shpalljes dhe rishikimit të aktgjykimit në këtë rast. Trupi gjyqësor ka tre muaj kohë që të marrin një vendim për çështjen, ose të kërkojnë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit. Seanca e fundit është mbajtur vetëm një ditë pasi mijëra qytetarë, në 18-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishin mbledhur në Prishtinë në mbështetje të katërshes të UÇK-së dhe për të kërkuar gjykim të drejtë. Zyra e Prokurorit të Specializuar ka kërkuar 45 vjet burgim për secilin.

EPOKA
ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 18 shkurt - Çështja gjyqësore kundër liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, ka përfunduar, pas gati tri vjetëve. Të mërkurën e 18 shkurtit, avokatët e ish-presidentit të Kosovës Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli e Jakup Krasniqi si dhe ish-deputetit Rexhep Selimi, kanë dhënë argumentet e tyre të fundit mbrojtëse.

Ata kanë përsëritur argumentet e tyre se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nuk ka dëshmi për akuzat e ngritura dhe nuk ka arritur ta provojë fajësinë e tyre, prandaj kanë kërkuar aktgjykim shfajësues. Më pas, mbrojtja e viktimave, ka thënë para trupit gjyqësor se





Hashim Thaçi: Akuzat nuk qëndrojnë. I vetmi njeri që po bënte plane morbide ishte Millosheviqi

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka nisur fjalën e tij përfundimtare para trupit gjykues, duke uruar qytetarët e Kosovës për Ditën e Pavarësisë. Thaçi ka përsëritur para trupit gjykues se është plotësisht i pafajshëm. “Të nderuar gjyqtarë, për vjet vite në këtë sallë të gjyqit i keni dëgjuar akuzat e prokurorisë dhe argumentet e mbrojtjes. Ju i keni parë faktet, ju e keni dëgjuar të vërtetën. Është vetëm një e vërtetë: akuzat nuk qëndrojnë. Unë jam plotësisht i pafajshëm”, ka thënë Thaçi.

Thaçi ka hedhur poshtë pretendimet e ZPS-së së ia ka pasur qëllime ta merrte kontrollin në Kosovë, duke thënë se asokohe studionte në Zvicër. “Në kohën e masakrave në Qirez, Prekaz e Likoshan në fillim të vitit 1998 unë isha student në universitetin e Zurihit, dhe atëherë nuk po bëja plane për ta marrë kontrollin në Kosovë, por për t’i kaluar provimet”, ka thënë Thaçi.

Ai ka theksuar se i vetmi njeri që po bënte plane morbide ndaj shqiptarëve ishte Slllobodan Millosheviqi, për një gjenocid të ri në Kosovë. “I vetmi njeri i cili po bënte plane morbide ishte Slllobodan Millosheviqi. Duke i parë masakrat në vendim tim nuk mund të qëndrojë indiferent, vendosa të vi në Kosovë. Ndërsa atë që do të bënte secili prej jush”, ka thënë Thaçi.

Thaçi gjithashtu ka shprehur keqardhje për viktimat e luftës në Kosovë, duke thënë “unë bashkëndiej dhe shpreh keqardhje për të gjitha viktimat që kanë pësuar në Kosovë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike”.

Më tutje, Thaçi ka thënë se ka qenë bashkëpunues me të gjithë dhe se qëllimi i tij ka qenë ta ndërtojë një Kosovë tolerante dhe shumetnike. “Si mund të pretendojë dikush që në kishim për qëllim ta merrnin kontrollin në Kosovë kur ne pranuan që bashkësia ndërkombëtare të

kishte fjalën kryesore në Kosovë dhe pastaj që UÇK-ja t’ia dorëzonte armët NATO, ashtu siç ndodhi”, ka thënë ai.

Thaçi ka nënvizuar se kishte punuar me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) pas përfundimit të luftës dhe me dhe partitë e tjera politike “për të ndihmuar në zbatimin e mandatit të tij në të mirë të popullit të Kosovës”. “Gjatë gjithë Kosovës, i vetmi pushtet që kisha, ishte pushteti i zërit tim. Të nderuar gjyqtarë, siç e keni parë edhe gjatë gjykimit tim, unë e përdora zërin tim për ta promovuar një shoqëri shumetnike, tolerante në vendin tim, Kosovë. Unë u bëra thirrje serbëve lokalë të qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe të ndërtojnë një të ardhme me ne. Edhe serbët, sikurse ne, ishim viktimat të Millosheviqit”, ka thënë ai, duke shtuar se UÇK-ja ishte organizim popullor që po mbrohej nga një shtet agresor.

Ish-presidenti i Kosovës ka vazhduar me kundërshtimin e akuzave të ZPS-së, duke thënë se e vërteta është e kundërta e asaj që ajo e ka thënë për të në gjykatë. “Kjo Prokurori më thuri shumë lavde e më ndau shumë tituj e grada, por e vërteta është krejt tjetër. Unë nuk isha ai që e transportova rezistencën nga Perëndimi në Kosovë, unë iu bashkova rezistencën në Kosovë. Nuk ishte kthimi im nga Perëndimi pse UÇK-ja po masivizohej, arsyeja ishte

Millosheviqi. Askush më bukur nuk e ka thënë këtë sesa ish-sekretarja e Shtetit e ShBA-së, Madeleine Albright, citoj: ‘Millosheviqi me sjelljet e tij ndaj popullit të Kosovës është rekrutuesi më i madh i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës’, ka thënë Thaçi, duke shtuar se UÇK-ja nuk ishte shteti, nuk ishte ushtri e një shteti, por ishte organizim popullor që po mbrohej nga një shtet agresor.

“Fakti që UÇK-ja nuk ishte organizuar ashtu siç prokuroria pretendon se ishte, nuk e zbeh aspak rolin e saj për lirinë e Kosovës, nuk e bën kauzën e saj për çlirim më pak fisnike e as arritjen e pavarësisë më pak historike. Fitorja e Kosovës ishte më shumë politike e diplomatike. Suksesi më i madh i Kosovës ishte bashkëpunimi i plotë dh besimi me Perëndimin. Ata na ndihmuan pikërisht sepse e dinin se kush ishin dhe çfarë qëllimi kishin. Unë me asnjë çmim, në asnjë rrethanë, nuk do ta rrezikoja këtë aleancë me asgjë në këtë botë, sepse ashtu do ta rrezikoja vetë lirinë e Kosovës dhe ekzistencën tonë kolektive”, ka thënë Thaçi, duke shtuar se synimi i tij ishte paqja, e jo lufta.

Në përmbylljes të fjalës së tij, Thaçi ka thënë se në vend që ZPS-ja t’ia heq renë e zezë Kosovës, kërkon që t’ia mbyll diellin me stuhi. “Ne besuam që ajo do t’i trajtonte akuzat në raportin e Martyt dhe do të

vepronte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, në praktikë, asnjëra as tjetra nuk ndodhi. Unë jam kritikuar shumë dhe kritikohem ende në Kosovë, pse e mbështetëm këtë gjykatë. Kritikët thonë se kjo gjykatë e synon kriminalizmin e luftës tonë për liri, dhe idenë e pavarësisë. Këtë nuk e kam besuar në atë kohë, kur e kam votuar, por uroj sinqerisht që koha të dëshmojë që unë kisha të drejtë e kritikët e kishin gabim. Kjo prokurori në vend që t’ia heq renë e zezë Kosovës, kërkon t’ia zë diellin me një stuhi të zezë, të ashtuquajturën Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”, ka thënë Thaçi.

Kadri Veseli deklarohet i pafajshëm: Unë e di kush jam dhe çfarë kam bërë, veprimet e mia ishin ligjore - drejtësia mund të vonohet, por jo të mohohet

Pas Thaçit fjalën e ka marrë ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Para trupit gjykues, Veseli ka thënë se drejtësia ndonëse mund të vonohet, por ajo nuk mund të mohohet. “Unë e di kush jam, çfarë kam bërë dhe çfarë nuk kam bërë... Veprimet e mia kanë qenë ligjore”, ka thënë ai.

Ai ka thënë se Gjykata Speciale duhet me çdo kusht ta mbrojë të vërtetë, drejtësinë dhe paanësinë. “Edhe në momentet më të errëta nuk e humba besimin se e vërteta do të triumfojë. Liria nuk mund të arrihet prej padrejtësisë. Familja ime dhe unë kemi jetuar në persekutim të vazhdueshëm. Unë e di çka do të thotë të jetosh në kërcënim të vazhdueshëm, kjo është një përvojë që nuk do të ia dëshiroj askujt. Pas dekadash hetime dhe dokumentesh, nuk ka asnjë provë se kam kryer krime”, ka thënë Veseli.

Veseli, ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nuk ka asnjë provë që tregon se ai ka kryer ndonjë krim. “Pas dekadash hetimesh dhe dëshmisë të panumërta, nuk ka asnjë provë që të tregojë se kam kryer ndonjë krim. Nuk është provuar asnjë veprim i kundërligjshëm nga ana ime. Kjo nuk është çështje interpretimi por çështje fakti”, ka thënë ai.

Veseli ka thënë se nuk ka marrë pjesë në luftë nga “dëshira për konflikt”. Edhe Veseli ka thënë se ishte kthyer në Kosovë, meqë nuk ka mundur që qëndrojë indiferent para vuajtjeve që po përjetonte populli i tij. “Si i ri, edhe unë kam dëshiruar një jetë të qetë, të jetoja në paqe dhe dinjitet me familjen time. Kam qenë student kur u shfuqizua autonomia e Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës u sulmua nga forcat serbe. Kam marrë pjesë në aktivitetet paqësore për t’i mbrojtur të drejtat tona themelore”, ka deklaruar Veseli, duke shtuar se jeta e tij nuk kishte kuptim vetëm nëse populli i Kosovës mund të jetonte në liri. “Terrori dhe masakrat si ato në Srebrenicë filluan me ndodhë edhe në vendin tim, në Kosovë. S’mund të qëndroja indiferent. Jeta ime kishte kuptim vetëm nëse populli im mund të jetonte në liri, prandaj u ktheva në Kosovë. Jo si ushtar i trajnuar, por si student”, ka thënë Veseli.

Veseli ka shtuar se liria s’mund të arrihet përmes padrejtësisë dhe as paqja nuk mund të ndërtohet mbi krim. “Po ju drejtohem për të theksuar një pikë të vetme, gjykata duhet me çdo kusht të mbrojë drejtësinë, të vërtetën





dhe paanësinë. Kjo është edhe kontributi i saj i madh, dhe trashëgimia që do të mbetet prej kësaj gjykate. Ky është shkaku pse ju bashkova atyre mijëra grave dhe burrave që u rreshtuan në radhët e UÇK për lirinë e Kosovës. Dhe pse i kam shërbyer vendit tim, që çdo qytetar të gëzoj drejtësi. Në momentet më të errëta nuk e humba kurrë besimin se e drejta e vërteta dhe liria do të triumfonin. Kam besuar gjithmonë se populli i Kosovës kishte të drejtën për të jetuar në liri dhe dinjitet. Kam besuar se vuajtët do të merrnin fund, dhe se drejtësia do të vinte edhe nëse me vonë. Kurrë nuk kam besuar se dhuna, urrejtja dhe hakmarrja mund të jenë udhërrëfyes të ndershëm. Ato shkatërrojnë shpirtin e një populli. Liria nuk mund të arrihet përmes padrejtësisë, as paqja nuk mund të ndërtohet mbi krim. Një kauzë e drejtë nuk mund të mbrohet me mjete të padrejta”, ka thënë Veseli. Edhe Veseli në fund të fjalës së tij ka uruar qytetarët e Kosovës për Ditën e Pavarësisë. “Urime Pavarësia! Ta gëzoni qytetarë të Republikës së Kosovës lirinë. Zoti e ndihmoftë Kosovën dhe njerëzit e saj të mirë”, ka thënë Veseli, duke mos harruar ta përshëndet familjen dhe ekipin e tij të avokatëve.

Rexhep Selimi: Jam i pafajshëm. Historia s’mund të rishkruhet, armët për ne ishin mbijetesë

Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi, në fjalën e tij përfundimtare të mërkurën ka thënë se historia e Kosovës nuk mund të rishkruhet në një sallë gjyqi. Para trupit gjykues në Hagë, Selimi ka deklaruar se UÇK-ja nuk është krijuar nga dëshira, por nga nevoja dhe se armët për ta ishin mbijetesë. “Kur Serbia dhe Millosheviqi vrisnin bashkëmoshatarët e mi, helmonin nxënësit dhe studentët, i largonin prindërit tanë nga puna, mbyllnin shkollat e spitale, na ndiqnin për të na vrarë, dhe zbatonin spastrim etnik e gjenocid, çfarë duhej të bënim

ne, të mos reagonim? Serbia kurrë nuk e fshehu qëllimin e saj ndaj shqiptarëve. Prandaj pyes sërish: Çfarë duhet të bënim ne? Të prisnim radhën për t’u vrarë, apo të iknim nga shtëpitë tona? UÇK-ja nuk u krijua nga dëshira por nga nevoja”, ka thënë Selimi. Më tutje, Selimi është shprehur i bindur se kanë bërë gjënë e duhur. “Edhe sot do ta bëja të njëjtën gjë. Prandaj na mbështeti NATO-ja”, ka thënë Selimi, duke shtuar se cilësimi si njeri nga themeluesit e UÇK-së është një nder, bashkë me të qenit luftëtar me komandantin legjendar, Adem Jashari. “Për mua, të qenit bashkëluftëtar i Adem Jasharit ishte nderi më i madh që mund ta kisha, e konsideroj edhe nder cilësimit si njeri nga themeluesit kryesorë të UÇK-së. Nëse këto cilësime shndërrohen në akuza, atëherë problemi nuk qëndron te unë, por te ata që nderin dhe përgjegjësinë i trajtojnë si faj. Po, kam baruar armë, ishin për mbijetesë. Shumë bashkëluftëtarë kanë vdekur duke i siguruar ato”, ka thënë Selimi. Ai ka thënë para trupit gjykues se shpreson se gjykimi ndaj tij mund të shërbejë si një mundësi për drejtësi. “Pas gjithë këtyre viteve, ka edhe një element pozitiv, shpresoj se trupi gjykues e ka pasur kohën e mjaftueshme për ta kuptuar se lufta jonë ishte e drejtë dhe se pretendimet e prokurorisë nuk qëndrojnë”, ka thënë Selimi.

Selimi është shprehur i bindur se

akuzat ndaj tij dhe shokëve të tij, janë të pabazuara dhe të padrejta. “Nuk jam këtu për ta mbrojtur veten, sepse këtë gjë e bëjnë avokatët e mi, por ju duhet ta ushtroni drejtësinë. Prokuroria po mbështetet në pretendime që nuk kanë bazë dhe po bën përpjekje të vazhdueshme për ta njollosur luftën e UÇK-së”, ka thënë Selimi. Më tutje Selimi është treguar i ashpër ndaj ZPS-së, duke deklaruar se kjo prokurori ka krijuar përshtypjen se pavarësinë e Kosovës e ka trajtuar si qëllim kriminal. “Prokuroria edhe pse në fillim të paraqitjes së saj, deklaroi se nuk kërkon dënimin e shtabit të përgjithshëm, gjatë gjithë Kosovës, shënjestër ishte pikërisht Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së dhe në veçanti qëllimi i saj, Pavarësia e Kosovës. Po krijohej një përshtypje sikur vet pavarësia po trajtohej si qëllim i përbashkët kriminal”, ka thënë Selimi. Ish-komandanti i UÇK-së, Rexhep Selimi, i emocionuar ka folur për Kosovën e lirë, për të cilën ka thënë se është i gatshëm ta japë jetën nëse i kërkohet. Ndonëse ka thënë se nuk e di se kur do të kthehet në Kosovë pasi kjo varet nga vendimi i gjykatës, megjithatë siç u shpreh, do kthehet në Kosovën e lirë. “I bindur se bëmë gjënë e duhur, edhe sot do ta bëja të njëjtën gjë. Na mbështeti edhe NATO dhe vendet tuaja. Prokuroria kërkon

dënime jashtëzakonisht të rënda, aq të gjata sa synojnë të na ndalojnë përgjithmonë kthimin në vendin tonë. Koha se kur do të kthehem në Kosovë, tash e tutje, varet nga vendimi juaj. Por prokuroria duhet ta ketë kuptuar se, kurdo që të kthehem, unë do të kthehem në Kosovën e lirë. Në Kosovën për të cilën jam krenar që i dola zot në kohën më të duhur dhe për lirinë e së cilës jam i gatshëm të jap jetën”, ka thënë Selimi, duke shtuar se ZPS-ja do të duhej ta kuptonte se kurdo që lirohet nga Haga, do kthehet në Kosovën e lirë. “Prokuroria në dosjen e saj përfundimtare kërkon dënime jashtëzakonisht të rënda. Aq të gjata sa që në thelb synojnë të na ndalojnë përgjithmonë kthimin në vendin tonë. Koha se kur të kthehem në Kosovë, tash e tutje është në duart tuaja, por Prokuroria do duhej ta kuptonte, se kurdo që të kthehem, unë do kthehem në Kosovën e lirë”, ka thënë Selimi.

Jakup Krasniqi: Jam i pafajshëm, akuzat e prokurorisë janë shpifje

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, e ka nisur fjalimin e tij përmbyllëse duke thënë se “tërë jetën time e kam kaluar i udhëhequr nga bindja se qeniet njerëzore meritojnë të jetojnë në liri”.

“Qëndroj para jush jo si një kriminel siç më paraqet aktakuza e prokurorisë, por si një njeri i lindur dhe i kalitur në luftëra për dinjitet njerëz, në një popull që refuzoi që të zhdukej nga politikat e krimit dhe gjenocidit të Serbisë”, ka thënë Krasniqi. Krasniqi ka akuzuar Gjykatën Speciale se ia ka mohuar të drejtat e tij duke e mbajtur në paraburgim nga viti 2020. “Për më shumë se pesë vjet, besoj se më janë mohuar të drejtat e njeriut nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër to më e rëndësishmja është e drejta për të jetuar në liri, veçanërisht e drejta e një njeriu në fundin e fazës së jetës së tij për të jetuar vitet e mbetura me dinjitet pranë familjes dhe në atdheun e lirë”, ka thënë ai, duke shtuar se nuk i ka bërë keq askujt. “Kjo më është bërë pa i shkaktuar padrejtësi askujt, pa ia rrezikuar jetën asnjë njeriu të vetëm. Përkundrazi, kam rrezikuar jetën time”, ka thënë ai. Krasniqi ka thënë se ky është viti i 16-të nga 75 vitet e jetës së tij që ka kaluar në burg, me të vetmin qëllim, për lirinë e Kosovës. “Sot ndodhem në vitin tim të 16-të të burgimit vetëm pse luftova për liri dhe pavarësi të popullit tim. Po them vitin e 16-të sepse 10 vjet e më tepër burgim i kam kaluar nga viti 1981 deri në vitin 1991. Të kesh kaluar 16 nga 75 vitet e jetës në burg dhe të jesh privuar nga ajri i lirisë, nuk është diçka e vogël, është diçka e madhe”, ka thënë Krasniqi. Në vazhdim, Krasniqi ka mohuar akuzat e prokurorisë lidhur me të, duke thënë se i janë veshur role, autoritet dhe përgjegjësi që nuk i kam pasur kurrë. “Kjo është shpifje. Figura e përshkruar në dokumentin e prokurorisë nuk është njeriu që qëndron sot para jush. Unë nuk zotëroja pushtetin, komandën apo funksionet që m’u atribuohen në këtë rast. E gjithë bota e di se NATO-ja ndërhyri kundër krimeve të kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë. NATO-ja dhe bota demokratike nuk janë rreshtuar kurrë përkrah terroristëve”, ka thënë Krasniqi. Ai ka ngulur këmbë se veprimet e tij dhe ato të UÇK-së, si gjatë luftës, ashtu edhe pas saj, i “dhanë përparësi paqes dhe kjo është dëshmuar”. “Ne qëndrojmë sot këtu padrejtësisht”, ka thënë Krasniqi.



MYFTIU TËRNAVA: MESAZHI I RAMAZANIT ËSHTË PAQJA, PASTRON ZEMRËN NGA URREJTJA DHE NDALON FYERJEN

PRISHTINË, 18 SHKURT - Sot (e enjte) fillon muaji i shenjtë i Ramazanit. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, në një konferencë për medie ka dhënë mesazhin dhe urimin për muajin e shenjtë të Ramazanit. Ai ka thënë se Ramazani na thërret ta forcojmë lidhjen me Zotin dhe përgjegjësinë ndaj vendit tonë, institucioneve dhe të ardhmes sonë të përbashkët. Tërnavë ka thënë se gjatë këtij muaji të shenjtë bëhet edhe reflektim për formësimin e dashurisë ndaj fesë dhe atdheut. “Na edukon me drejtësi, dhembshuri dhe moral të lartë dhe na udhëzon drejt paqes së brendshme. Ramazani është shkolla e shpirtit, ku besimtari pastrohet nga gabimet, forcohet në besim dhe rritet në devotshmëri. Është koha kur

leximi i Kuranit bëhet frymëmarrje e zemrës, lutja gjuhë e shpirtit dhe sadakaja dritë në rrugën tonë. I dërguari Muhamedi a. s. ishte njeriu më bujar, ndërsa bujaria e tij arrinte kulmin pikërisht në këtë muaj të bekuar. Në këtë natë të bekuar, kur hëna e Ramazanit ngrihet mbi horizontin shpirtëror të vendit tonë, le të reflektojmë për dy dashuri që na formësojnë: dashurinë ndaj fesë dhe dashurinë ndaj atdheut. Ramazani është më shumë se agjërime. Është shkollë hyjnore, vetëpërmbytje, pastrim i ndërgjegjes dhe lartësim moral. Ai e bën njeriun më të ndjeshëm ndaj tjetrit dhe më të përkushtuar ndaj së mirës së përbashkët. Historia jonë dëshmon se besimi ynë ka qenë burim frymëzimi për angazhimin qytetar dhe



kombëtar, veçanërisht në momentet kyçe si shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, kur u kurorëzua sakrifica e gjatë për liri, drejtësi dhe dinjitet. Dashuria ndaj fesë dhe atdheut nuk janë në kundërshtim, por plotësojnë

njëra-tjetrën. Besimi e formon karakterin, ndërsa atdheu i jep hapësirë veprimi. Ramazani na thërret ta forcojmë lidhjen me Zotin dhe përgjegjësinë ndaj vendit tonë, institucioneve dhe të ardhmes sonë të përbashkët. Agjërimi në muajin e shenjtë të

Ramazanit është një nga adhurimet më të veçanta, sepse është ibadet që besimtari e kryen vetëm për hir të Krijuesit, me bindje të plotë, vullnet të lirë dhe sinqeritet të thellë shpirtëror”, ka thënë ai. Myftiu Tërnavë ka bërë thirrje të ruhet vëllazëria dhe kombi me zemër të pastër dhe vendosmëri. “Mesazhi i Ramazanit është paqja. Pastron zemrën nga urrejtja, ndalon fyerjen dhe ngre respektin në themel të bashkëjetesës. Është thirrje për vetëpërmbytje, vëllazëri dhe dashuri aktive që sjell harmoni shoqërore. Nxitja e urrejtjes është mëkat i rëndë dhe tradhti ndaj frymës së këtij muaji. Ta ruajmë vëllazërinë dhe kombin tonë, me zemër të pastër dhe vendosmëri që dashuria të triumfojë mbi çdo përçarje”, ka thënë Tërnavë.

DËSHMITARI TANEVSKI PËR SULMIN NË BANJSKË: ENDE KAM TRAUMA, NUK DO TË VIJ MË NË KOSOVË

PRISHTINË, 18 SHKURT - Turisti nga Maqedonia e Veriut, Goran Tanevski, i cili ka përjetuar sulmin e 24 shtatorit 2023 në Banjaskë të Zveçanit, ka përjetuar traumë të rëndë psikologjike. Tanevski ka dëshmuar të mërkurën në seancën gjyqësore për rastin e sulmit në Banjaskë ndaj të akuzuarve Blagoje Spasojeviq, Vladimir Toliq dhe Dushan Maksimoviq. Prokurori special, Naim Abazi, e ka pyetur dëshmitarin nëse e ka tejkaluar ankthin e përjetuar gjatë sulmit në Banjaskë, ndërsa Tanevski ka thënë se ende përballet me probleme psikologjike. “Edhe më tej kam probleme të tilla”, ka thënë ai. Po ashtu, prokurori Abazi e ka pyetur dëshmitarin se gjatë vizitës së tij me familje në Banjaskë, a ka vërejtur persona të tjerë që nuk dukeshin si turistë. Tanevski ka thënë se në mëngjesin e ditës së sulmit nuk kishte parë persona që dukeshin si turistë, ndërsa në momentin e sulmit dëgjoheshin të shtëna armësh dhe më pas kishte parë persona të uniformuar rreth hotelit, dy prej të cilëve jashtë objektit dhe një brenda hotelit, të tre të armatosur. “Deri në ditën e



ndodhjes, në atë mëngjes nuk kam parë persona që janë dukur turistë. Në ditën që ndodhi kjo dëgjoheshin gjuajtje. Ne nuk mund të shihnim asnjë, por në atë mëngjes pamë persona të uniformuar rreth hotelit dhe kishte një në hotel. Njerëzit që i pamë jashtë hotelit ishin dy veta në uniformë, pa shenja dhe me armë ushtarake. Atij që ishte në hotel mund t’ia shihnim vetëm pushkën, kurse uniformën jo, sepse ne ishim poshtë shkallëve dhe ai po kërkonte batanije apo diçka të tillë. Nën dritaren në të cilën ishim të vendosur ne, pamë personin që po flas, i cili kishte municion, kishte bombë”, ka thënë ai. Dëshmitari, duke kujtuar ditën kritike, ka thënë se një nga personat e uniformuar kishte kërkuar çarçaf dhe e shoqja i

kishte dhënë batanije. Më pas, sipas dëshmitarit, personi i uniformuar u kishte kërkuar mysafirëve të qëndronin në dhoma dhe të mos dilnin jashtë hotelit. “Na kërkoi një çarçaf. Kur na kërkoi unë isha në pjesën tjetër të hapësirës, ndërsa gruaja i ka dha një batanije. Sa i përket pyetjes së kufizimit në dhoma, nuk kishte diçka të tillë. Kishte një thirrje që të qëndronim në dhomë, sepse dikush dëshironte të dilte. Ne u nisëm të dilnim, por dikush na tha prej katit të hotelit të ktheheshim në hotel. Unë doja të dilja që të shihja automjetin tim, por dikush na tha të kthehemi. Mendoj se ishte një nga personat e uniformuar, sepse ai person kishte edhe armë me vete”, ka thënë ai. Sipas dëshmisë së tij, ata ishin fshehur në bodrum disa orë për shkak të të shtënave dhe eksplozimeve jashtë hotelit. Në momentin që kishin përfunduar të shtënat, mysafirët janë kthyer në dhoma. “Vështirësitë ishin fillimisht si rezultat i gjuajtjeve dhe eksplozimeve që ishin jashtë hotelit. Pastaj, kur zbardhi dita të nesërmen, kur i pamë këta persona të uniformuar,

vendosëm të fshiheshim në bodrum. Dhe aty qëndruam 2-3 orë, pastaj u ndalën gjuajtjet një kohë dhe u kthyem në dhomë”, ka thënë ai. Tanevski ka thënë se ngjarja ka lënë pasojë të rënda psikologjike tek ai dhe familja e tij, duke theksuar se pas asaj dite kishte vendosur të mos vizitojë më Kosovën. Ai ka thënë se nuk mund ta harrojë tmerrin që ka përjetuar më 24 shtator të 2023-s, pasi ishte ndier përgjegjës për atë që kishte përjetuar familja e tij, duke u frikësuar se mos po e qëllon ndonjë plumb. Frika e tij më e madhe ishte fëmija i tij me autizëm. Tanevski ka thënë se familja e tij ishte larguar nën sigurinë e Policisë së Kosovës. “Unë prej asaj dite vendosa të mos vijë asnjëherë në Kosovë. Ajo që ndodhi atë ditë asnjëherë nuk mund ta harroj. Unë i dërgova ata atje që të pushonim, por u ndjeva përgjegjës për atë që ata përjetuan. Edhe sot e kësaj dite, kur më kujtohet ajo që ndodhi, ndiej stres, pasiguri dhe frikë. Në orën 15:00 dëgjuam gjuajtje dhe eksplozime. Kishim frikë se mos na qëllonte ndonjë plumb. Pastaj, kur zbardhi dita, pamë ushtarë jashtë me armë, kishte edhe më

tej gjuajtje. Kur u ndalën gjuajtjet, unë komunikova me Ministrinë e Jashtme dhe m’u tha se nuk mund të shkoja se nuk është e sigurt. Gjithë ditën ishte dilema se a të shkonim a jo. Ne shkuam të hënën, do të thotë paradite, duke na siguruar Policia e Kosovës. Gjithë ajo kohë paraqet stres dhe frikë. Unë kam një fëmijë me autizëm që ka qenë aty. Nuk e di a e dini çfarë do të thotë kjo”, ka thënë ai. Deri më tani të arrestuar dhe nën masën e paraburgimit për këtë rast janë Blagoje Spasojeviq, Vladimir Toliq dhe Dushan Maksimoviq, për të cilët është veçuar procedura penale. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës më 11 shtator 2024 ka ngritur aktakuzë kundër Milan Radoiçiqit dhe 44 të tjerëve për sulmin terrorist të 24 shtatorit 2023 në Banjaskë të Zveçanit. Të akuzuarit ngarkohen se përmes përdorimit të dhunës me armatim të rëndë, tentuan ta shpëpusin pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës e t’ia bashkojnë Republikës së Serbisë, me ç’rast ka mbetur i vrarë rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku.

Jakaj: Ndryshimi i ligjit i jep fund padrejtësisë ndaj veteranëve të UÇK-së

Prishtinë, 18 shkurt - Hulumtuesi i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Naim Jakaj, ka kërkuar ndryshim të dispozitave ligjore për trajtimin e pensioneve të veteranëve të UÇK-së, duke theksuar se aktualisht ekziston trajtim i pabarabartë në mes të veteranëve në sektorin publik

dhe privat. Sipas tij, përkundër deklaratimeve publike për vlerësimin e kontributit të veteranëve, nevojiten veprime konkrete institucionale për eliminimin e dallimeve aktuale në përfitime në Kosovë. “Ka pasur shumë fjalë të mira dje për veteranët. Por, fjalët nuk mjaftojnë. Duhet vepra. Sot

shteti i trajton veteranët në mënyrë të pabarabartë: Veteranët në sektorin publik nuk e përfitojnë pensionin e veteranit. Vetëm ata në sektorin privat e gëzojnë këtë të drejtë. E njëjta luftë, i njëjti kontribut, trajtim i ndryshëm. Zgjidhja është e thjeshtë: Ndryshohet një dispozitë e Ligjit për Veteranët

dhe hiqet kjo padrejtësi”, ka theksuar ai. Ai ka bërë thirrje që përmes nismës legislative institucionale ose përmes peticionit qytetar, çështja të dërgohet për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës, me synim sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë veteranët.



Bajrami: Ka ardhur koha të ndërrohet Kushtetuta e Kosovës, presidenti të zgjedhet nga populli

PRISHTINË, 18 SHKURT - Profesori dhe akademiku Arsim Bajrami ka thënë se Kosova duhet ta ndërrojë Kushtetutën dhe presidenti i vendit të zgjedhet nga qytetarët. Këto deklarime i ka bërë Bajrami në një intervistë për "RTK", në të cilën ka folur për procesin problematik të zgjedhjes së presidentit në Kuvendin e

Kosovës. Ai ka thënë se gjithmonë po shfaqet nevoja për një marrëveshje politike për të bërë votat e mjaftueshme për zgjedhjen e presidentit të ri dhe, sipas tij, është koha e fundit që të ndërrohet Kushtetuta. "Mendoj se ka ardhur koha e fundit që ne ta ndryshojmë Kushtetutën në pjesën që ka të

bëjë me presidentin. Janë pjekur kushtet që të bëhet reforma në mënyrë që presidenti të zgjedhet nga populli", ka thënë Bajrami, duke shtuar se një gjë të tillë e kanë bërë të gjitha shtetet e rajonit. "Kemi mbetur vetëm ne, Shqipëria dhe Greqia, që ende e zgjedhin përmes Parlamentit", ka thënë Bajrami.



BE-ja: STATUSI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE SHËNDETËSORE SERBE NË KOSOVË TË ZGJIDHET NË DIALOGUN E BRUKSELIT

PRISHTINË, 18 SHKURT - Statusi i strukturave dhe shërbimeve shëndetësore dhe arsimore që Serbia i mbështet në Kosovë do të zgjidhet në kuadër të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në përputhje me marrëveshjet e arritura dhe ligjet në fuqi të Kosovës, thuhet në përgjigjen e një zëdhënësi të Bashkimit Evropian për "Radion Evropa e Lirë". "Kryeministri Kosovës, Albin Kurti, është zotuar se do ta trajtojë integrimin e strukturave shëndetësore dhe arsimore që mbështeten nga Serbia, në konsultim me serbët e Kosovës dhe BE-në, veçanërisht me përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës", ka thënë zëdhënësi i BE-së.

Institucionet shëndetësore dhe arsimore në mjediset me shumicë serbe në Kosovë funksionojnë në bazë të sistemit të Serbisë dhe janë pothuajse të vetmet që autoritetet e Kosovës nuk i kanë mbyllur. Që nga fillimi i këtij viti është aktualizuar çështja e integritetit të këtyre institucioneve në sistemin e Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 16 janar ka njoftuar se procesi i integritetit të shëndetësisë dhe arsimit serb do të zhvillohet në koordinim me Bashkimin Evropian, duke theksuar se do të merren parasysh edhe shqetësimet e



komuniteteve joshumicë. Megjithatë, nuk është saktësuar se cilat modele integriteti po shqyrtohen dhe nëse ky proces do të zhvillohet në kuadër të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, siç insiston Beogradi.

"Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar Qeverisë së Kosovës me pyetje lidhur me këtë çështje dhe është në pritje të përgjigjes. Palët janë pajtuar për

Asociacionin më 2013 dhe ai përmendet edhe në Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve të cilën Kosova dhe Serbia e kanë pranuar në vitin 2023. Sipas një draft-statuti që hartoi Bashkimi Evropian, Asociacioni do të duhej ta rregullonte edhe çështjen e të hyrave, përkatësisht financimin nga buxheti i Serbisë.

Ndërkaq njoftimi për nisjen e integritetit të institucioneve arsimore dhe shëndetësore përkon me fillimin e zbatimit të fazës së parë për zbatimin e plotë të Ligjit për të Huajt, që do të zgjasë deri më 15 mars dhe parasheh një periudhë informimi.

Zbatimi i plotë i këtij ligji mund të ndikojë në funksionimin e institucioneve shëndetësore dhe arsimore serbe, pasi

personat që nuk kanë dokumente të Kosovës duhet të kenë leje pune ose licencë për ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën kërkesa paraqitet në Agjencinë e Punësimit të Kosovës. Në praktikë, marrja e lejes së punës apo e licencës për arsimim mund të jetë problematike, pasi Kosova nuk i njeh institucionet e Serbisë të cilat i konsideron paralele dhe të paligjshme.

Haxhiu në pritje të kandidaturave për president, paralajmëron thirrjen e seancës pas sigurimit të nënshkrimeve

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se është në pritje të kandidaturave për ta thirrur seancën për zgjedhjen e presidentit. Në një deklaram për medie pas takimit që ka zhvilluar me kryetarët e komisioneve parlamentare, Haxhiu ka theksuar se sapo t'i

ketë nënshkrimet nga kandidatët për president, do të veprojë në lidhje me thirrjen e seancës për zgjedhjen e tij. "Sapo t'i kem nënshkrimet nga kandidatët do ta thërrasim seancën dhe do të procedojmë. Paraprakisht duhet të ketë takime", ka thënë ajo, duke shtuar se, ndonëse sipas disa

interpretimeve gjithçka duhet të përfundojë deri më 4 mars, ajo nuk mund të veprojë pa u plotësuar kushti i nënshkrimeve. Haxhiu njoftoi se është vendosur që takimet me kryetarët e komisioneve të jenë të rregullta, me synim rritjen e efikasitetit dhe shmangien e vonesave.



Miratohet në komision Projektligji për Buxhetin, opozita kërkon rritjen e pensioneve

PRISHTINË, 18 SHKURT - Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare dhe Peticione ka miratuar mes dy leximeve Projektligjin për Buxhetin për vitin 2026. Pro këtij projektligji kanë votuar gjashtë deputetë të mazhorancës, ndërsa kundër ishin katër deputetë

nga opozita. Debat në këtë komision ka ngjallur propozimi i deputetes së PDK-së, Sala Jashari, që pensionet e disa kategorive, përfshirë ato të veteranëve të UÇK-së, të barazohen me pagën minimale. Jashari ka kërkuar bashkëpunim për një amendament që do t'i rriste pensionet e veteranëve të

UÇK-së, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilat kanë mbetur 170-180 euro, ndërsa paga minimale 425 euro. Mirëpo deputetët nga Vetëvendosja kanë thënë se këto propozime do të shqyrtohen gjatë rishikimit të buxhetit muajin tjetër. Krahës kësaj, deputeti i PDK-së, Artan

Behrami, ka kërkuar nga komisioni ta shqyrtojë mundësinë e një vizite në Hagë te liderët e UÇK-së që po gjykohen nga Specialja. “Të thirren edhe ata që kanë kaluar këtë proces për t'i marrë përshtypjet e tyre për mosrespektimin e të drejtave të njeriut nga Gjykata Speciale”, ka thënë Behrami.



RAMA: NËSE QEVERIA NUK E PËRFSHIN BUXHETIN E PRISHTINËS NË BUXHETIN E SHTETIT, KY ËSHTË VENDIM POLITIK

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se do të ishte vendim politik nëse Qeveria e Kosovës nuk do ta përfshinte buxhetin e kryeqytetit në buxhetin e shtetit për vitin 2026. Rama ka thënë se çdo justifikim për mospërfshirje bie poshtë, kur “dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me ligjin”, dhe se kryeqyteti nuk është pronë e askujt. “Nëse qeveria nuk e përfshin buxhetin e kryeqytetit në buxhetin e vitit 2026, kjo nuk është thjesht vonesë administrative, është vendim politik! Buxheti i kryeqytetit është miratuar në asamblenë e kryeqytetit, me të gjitha specifikat teknike dhe ligjore, dhe është dorëzuar sipas procedurave. Çdo justifikim për



mospërfshirje bie poshtë kur dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me ligjin”, ka shkruar Rama në “Facebook”.

Më tutje, Rama ka shtruar disa pyetje për mospërfshirjen e buxhetit të Prishtinës në atë të shtetit për vitin 2026. “Prandaj

shtrohet pyetja: Pse nuk po përfshihet në buxhetin e vitit 2026? A është kjo hakmarrje politike? A është tentativë për ta

bllokuar zhvillimin e kryeqytetit? A po përdoret buxheti si mjet presioni ndaj qytetarëve të Prishtinës? Qeveria ka obligim kushtetues dhe ligjor të trajtojë buxhetin e kryeqytetit pa diskriminim politik. Çdo veprim ndryshe është shkelje e parimit të barazisë institucionale dhe goditje direkte ndaj qytetarëve. Prishtina nuk është pronë e askujt. Është kryeqyteti i Republikës dhe meriton trajtim institucional, jo kalkulime partiake. Nëse qeveria zgjedh ta mbajë peng buxhetin e 2026-s, atëherë le ta thotë hapur: qytetarë të kryeqytetit po ju ndëshkojmë sepse nuk na votuat neve!!! Qytetarët e Prishtinës meritojnë përgjigje!”, ka shkruar Rama.

KOSOVA DHE BRITANIA PAJTOHEN PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE TREGTAR

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim anëtarin e Dhomës së Lordëve, Lord Cromwell dhe deputetin e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, Martin Vickers. Lord Cromwell dhe Martin Vickers kanë uruar popullin e Kosovës për 18-vjetorin e Pavarësisë, të shënuar të martën si dhe e kanë përgëzuar Kurtin për mandatin e ri qeverisës. Siç ka njoftuar zyra e kryeministrit, gjatë takimit është diskutuar për marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, me theks të veçantë në bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar dhe mundësitë që Kosova ofron për investime dhe investitorë të huaj. Pjesë e diskutimit ishte edhe

siguria në rajon dhe në kontinent. “Kryeministri i falënderoi për vizitën dhe urimet, si dhe për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre në fuqizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Ai shprehu mirënjohje për rolin historik dhe kontributin e çmueshëm të Mbretërisë së Bashkuar në çlirimin, pavarësimin, shtetndërtimin dhe zhvillimin e Kosovës”, ka njoftuar zyra e kryeministrit. Është bërë me dije se Kurti ka theksuar se prioritetet e qeverisë, veçanërisht projektet e mëdha infrastrukturore të parapara për këtë mandat të ri, investimet kapitale që do të tejkalojnë vlerën prej një miliard eurosh në vit, duke përfshirë investimet në siguri dhe mbrojtje.



Zhblllokohet rruga drejt Malit të Zi, e kalueshme për të gjitha llojet e automjeteve

PRISHTINË, 18 SHKURT - Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK) ka njoftuar se është zhblllokuar rruga drejt Malit të Zi, që më parë ishte e


bllokuar për qarkullimin e kamionëve. Në njoftim është thënë se rruga është pastruar dhe është e kalueshme për të gjitha llojet e automjeteve. “Ju

njoftojmë se bazuar në komunikimin me zyrtarët kufitar të Malit të Zi, kemi marrë informacion se rruga është pastruar dhe është e kalueshme

për të gjitha llojet e automjeteve. Për më shumë kontaktoni QKMK-në në numrat e telefonit +383(0)45198606”, ka njoftuar QKMK-ja.



JETA E ALBERT EINSTEIN: NGA FËMIJË I VETMUAR TE NJERIU QË NDRYSHOI SHKENCËN



Albert Einstein është një nga mendjet më të mëdha në historinë e njerëzimit. Me teorinë e relativitetit ai ndryshoi përgjithmonë mënyrën si kuptojmë hapësirën, kohën dhe vetë universin. Por pas figurës së gjeniut fshihej një histori njerëzore e jashtëzakonshme, nga një fëmijë i vetmuar në Gjermani te shkencëtari që tronditi botën.

Anija nuk kish përfunduar së ankoruari në New York, në pasditen e 2 prillit 1921, kur një turmë gazetarësh, fotografësh dhe kameramanësh rendën të hipin në bord. Preja e tyre, Albert Einstein, i priste në këmbë, mbi urë. Ishte në vizitën e tij të parë në Shtetet e Bashkuara: mbante veshur një pallto leshi të errët si dhe një kapelë që vetëm pjesërisht ia fshihte flokët e thinjur. Në njërin dorë mbante një llullë, ndërkohë që me tjetrën shtrëngonte një kuti violine. “Duket si një artist”, shkruante të nesërmen The New York Times. “Por poshtë flokëve të shpupuritur ka një mendje shkencore, deduksionet e të cilës kanë shushatur mendjet më të mira të Europës”.

Kështu Amerika i jepte mirëseardhjen shkencëtarit që një herë e përgjithmonë kishte ndryshuar mënyrën tonë të perceptimit të hapësirës, kohës dhe universit. Dhe që prej pak vitesh – domethënë që kur

kryevepra e tij, teoria e përgjithshme e relativitetit ishte demonstruar prej vëzhgimeve astronomikë të dy ekipeve të pavarur studiuesish britanikë në 1919 – ishte rishfaqur në qendër të skenës, nga qarqet akademikë, në shtypin ndërkombëtar. Në atë kohë Einstein ishte një dyzetëvjeçar tërheqës, me maniera plot mirësjellje dhe joformale, dhe me zërin e qetë që shpesh herë dhe papritur i linte vend një të qeshure bombastike. E ardhmja e tij ishte në Amerikë, por e shkuara e tij kishte rrënjë të forta në Europë: në Gjermani, në Zvicër... dhe në Itali.

Albert Einstein ishte me autizëm?

I lindur në 14 mars 1879 në Ulm, në Gjermani, në një familje hebraike të borgjezisë së mesme, Albert Einstein ishte ende në pelena kur, në 1880, prindërit u transferuan në Mynih, aty ku babai Hermann kishte hapur së bashku me vëllanë e tij Jakob një kompani inxhinierie elektrike dhe hidraulike. Në fëmijërinë e hershme Albert kishte probleme të kuptuari dhe shqetësoi seriozisht familjarët e tij, që druhashin se mos ishte i vonuar: në fakt mësoi të flasë vetëm kur ishte 3 vjeç dhe nuk bashkohej me bashkëmoshatarët, por preferonte të luante i vetëm. Ndonëse zakonisht ishte i qetë,

shpesh herë bëhej pre e teprimeve të zemërimit. Disa studiues kanë hedhur kohët e fundit hipotezën që Albert Einstein i vogël vuante nga një formë e lehtë autizmi, apo një patologji e ngjashme e quajtur sindroma e Asperger, por kjo diagnozë e bërë në distancë kohore është e diskutueshme. Pas këtyre problemeve të fillimit, fëmija u rrit normalisht, bashkë me motrën e vogël Maja, në një ambient familjar të qetë dhe të pasur me stimuj kulturorë.

Në 1886 Albert Einstein nisi të frekuentojë shkollën fillore publike në Milano, dhe dy vjet më vonë u regjistrua në Gjimnazin Luitpold, në qytetin bavarez. Ndryshe nga një legjendë dashakeqe që e paraqet si një student shumë të keq, rendimenti i tij shkollor ishte gjithmonë i mirë, ndonëse është e vërtetë që i riu Einstein ndihej jo mirë me autoritarizmin në shkollat gjermane të kohës, dhe disa sjellje të tij irritonin ndonjë profesor.

Fazë mistike

Në kohën e lirë, Albert kultivonte pasionet e tij të mëdhenj: violinën dhe algjebren, por edhe leximin e librave të filozofisë, mes të cilave Kritika e arsyes së pastër e Immanuel Kant. Dhe që nga 1890 kaloi për një vit të tërë një fazë besimi intensiv, gjatë të

cilës respektoi me rrëptësi ritet hebraike: refuzonte për shembull mishin e derrit dhe thurte himne për Perëndinë. Në të kundërt nga ajo që thuhet ndonjëherë, ai nuk bëri asnjëherë ndonjë zgjedhje vegjetariane në të ushqyer, ndonëse në moshë të thyer do të pohonte: “Kam ngrënë gjithmonë mish me një brejtje të vogël ndërgjegjeje”. Në çdo rast, idili mistik u ndërpre kur djaloshi nisi të thellojë interesat e tij shkencorë; në vijim, Einstein u largua përfundimisht nga çdo formë besimi fetar.

Në qershor të 1984, Herman dhe Jakob Einstein u transferuan në Itali bashkë me familjet respektive. Fillimisht në Milano, e më pas në Pavia, ku hapën një stabiliment të ri menjë inxhinier italian. Në qytetin pavez, Einsteinët shkuan të jetojnë në një ndërtesë të lashtë që i përkiste poetit Ugo Foscolo. Ndërsa Albert qëndroi në Mynih për të përfunduar shkollën e lartë. Megjithëkëtë, duke qenë se u ndie i vetmuar, aspak i qetë e madje i terrorizuar nga perspektiva e afërt e shërbimit të detyruar, në pranverën e 1895 braktisi Luitpoldin pa marrë ende diplomën dhe u bashkua me familjen në Pavia. Këtu i kërkoi të atit që të niste praktikën për ta çliruar nga nënshtetësia gjermane për të marrë atë zvicerane. Muajt e mëpasshëm

në Itali ishin ndër më të lumturit e jetës së tij. I kaloi duke punuar për Hermann dhe Jakob, duke studiuar dhe udhëtuar në zbulim të Italisë jugore. Veç të tjerash, koha e qëndrimit aty i mundësoi të mësojë edhe pak italisht.

I refuzuar

Në tetor 1895, 16-vjeçari Albert Einstein provoi provimin e pranimit në politeknikun e Zyrihut, por nuk u pranua: pavarësisht vlerësimeve shumë të mirë në matematikë, fizikë dhe kimi, dështoi në testin e kulturës së përgjithshme (histori, gjuhë dhe letërsi gjermane). Megjithatë, arriti të hyjë në politeknik në vjeshtën e 1896, falë diplomës së pjekurisë që mori ndërkohë në shkollën zvicerane në Aarau. Në 4 vitet që pasuan në institutin e Zyrihut, Albert frekuentoi leksionet sidomos të fizikës teorike.

Përveç ndonjë mbrëmjeje në ndonjë koncert apo teatër, në Zyrih Einstein e kalonte kohën e lirë duke lexuar tekste filozofie, duke i rënë violinës, duke bërë shëtitje me varkë në liqen apo duke biseduar me miq në ndonjë kafene. Pak nga pak, personaliteti i tij nisi të përvijohet gjithnjë e më qartë. Dolën në pah, mbi të gjitha, antikonformizmi dhe antiautoritarizmi që e kishte shfaqur tashmë në

adoleshencën e hershme; veç kësaj, fëmija që luante i vetëm ishte shndërruar në një djalosh të ri që dinte t'ia kalonte shumë mirë në shoqëri, një interlokutor plot humor dhe me batuta të mprehta.

Një bijë misterioze

Në ata vite Albert Einstein pati një marrëdhënie të fortë dashurie me të vetmen femër në kursin e tij: Mileva Maric, një vajzë serbe që ishte larguar nga vendi i saj për t'u ikur vuajtjeve. Në fillim të 1902 ai pati një vajzë nga Mileva, jashtë martese, e quajtur Lieserl, fati i të cilës është krejt i panjohur: ndoshta u fik që e vogël, ose ndoshta u dha për adoptim, por në fakt çdo gjurmë e saj duket e zhdukur. Pasi u martuan në Bernë në 6 janar 1903, Einstein dhe Mariç patën edhe dy fëmijë të tjerë: Hans Albert, që erdhi në jetë në 1904 dhe më pas u bë profesor i inxhinierisë hidraulike në Berkeley, California, dhe i pafati Eduard, që lindi në 1910 dhe ndërroi jetë në 1965 në një spital psikiatrik, viktimë e një skizofrenie të rëndë.

Annus mirabilis

Mes viteve 1901 dhe 1904 Albert Einstein i kish dërguar shtypit disa memorie interesante për fizikën, të parat me firmën e tij. Por gjenialiteti i tij shpërtheu në 1905 me një shpërthim të paparë kreativiteti. Në atë vit mrekullish ai botoi në revistën gjermane Annalen der Physik katër artikuj themelorë në të cilët fuste risi konceptuale, të guximshme dhe të jashtëzakonshme, që do të përbënin bazën për zhvillimin e një pjese të madhe të fizikës së Nëntëqindës: ideja e dritës si bashkësi thërmijash, fotonesh si dhe shpjegimi i mëpasshëm i efektit të rëndësishëm

fotoelektrik (domethënë lëshimi i energjisë elektrike nga një metal i goditur nga drita); demonstrimi përfundimtar teorik i ekzistencës së atomeve; teoria e relativitetit, në të cilën hapësira dhe koha rezultonin të lidhura pazgjidhshmërisht; lidhja mes masës dhe energjisë së një trupi, e sintetizuar në formulën e famshme $E=mc^2$. Jo pak për një 26-vjeçar pothuajse të panjohur që kalonte tetë orë në zyrë dhe që, pa asnjë kontakt me qarqet universitarë, praktikonte fizikën sikur të ishte një argëtim.

Paratë e Nobelit... për bashkëshorten

Disa vite pas daljes së këtyre artikujve, më në fund karriera akademike e Einstein nisi fluturimin. Nga 1909 ai jepte leksione fizike teorike në Zyrih, Pragë, sërish në Zyrih dhe në 1914 u ngjit në katedër në Berlin. Ku, në nëntor të vitit të tjetër përfundoi elaborimin e lodhshëm të teorisë së relativitetit të përgjithshëm, apo teoria e gravitetit që sot është në themel të astronomisë dhe kozmologjisë bashkëkohore. Pasi fitoi famë planetare për shkak të kësaj kryevepre, mes viteve 1921 dhe 1925 Albert Einstein kreu shumë udhëtime në të gjithë globin. Por, nuk shoqërohej nga Mileva Mariç, nga e cila ishte ndarë në 1914, por nga kushërira Elsa Loewenthal, me të cilën u martua në 2 qershor 1919 dhe me të cilën qëndroi deri në vdekjen e saj në dhjetor 1936. Milevës, Einstein i la 33 mijë dollarët e Cmimit Nobel të 1921 për fizikën.

Raca njerëzore

I nderuar në të gjithë botën, Einstein megjithatë filloi të ketë probleme në Gjermani, duke

pësuar manifestime të ndryshëm antisemitizmi, që nga viti 1920. Veç kësaj, ultranacionalistët gjermanë dënonin me urrëjtje pozicionet e tij në fushën sociale dhe politike: përçmimin për militarizmin prusian, frymën libertariane, mbështetjen për kauzën pacifiste. Kështu në 1933, pasi Hitleri kishte ardhur në pushtet në Gjermani, Albert u zhvendos në Princeton, New Jersey, me një detyrë si docent për institutit të studimeve të përparuara. Eshtë i famshëm episodi ku, tek plotësonte formularin për lejën e qëndrimit në SHBA, pranë zërit Raca, Einstein shkruajti Njerëzore. Burimet thonë se ai shkruajti në mënyrë më prozaike “hebre” nën të njëjtin zë në listën e pasagjerëve të pranishëm në anijen që, në pranverën e 1921, e kish çuar për herë të parë në tokën amerikano veriore.

Vela, violinë dhe bamirësi


Albert Einstein u ambientua shumë shpejt në Princeton, ku krijoi miqësi të reja dhe bënte jetën e qetë që e donte aq shumë. Shpesh herë shihej të udhëtonte me varkë me vela në liqenin e qytetit, apo të jepte shfaqje me violinë në koncerte bamirësie: luante shkëlqyeshëm si amator që ishte, duke luajtur vepra të Bach, Mozart dhe Schubert. Pershtatur ne shqip nga bota.al Ndonjëherë shkonte në New York, natyrisht i shoqëruar nga të tjerë duke qenë se ai nuk kishte automobil dhe nuk mësoi asnjëherë ta ngasë. Si zakonisht, ishte shkenca që dominonte mendimet e tij. Aq sa një ditë, mu në mes të fjalës së një funksionari të lartë gjatë një pritje solemne për nder të tij, Einstein nxorri një laps dhe nisi të shkruajë disa ekuacione në pjesën e pasme të ftesës. Pasi mbaroi fjala, të gjithë u ngritën

në këmbë dhe nisën të duartrokasin në drejtim të tij. Në atë pikë, sekretarja e tij Helen Dukas i pëshpëriti në vesh që duhej të ngrihej: u çua, por filloi edhe ai të duartrokasë deri kur Helen i tha sërish që duartrokitjet ishin pikërisht për të. Deri në fund të jetës, Albert Einstein vazhdoi të jetë shumë aktiv në fushën e fizikës teorike. Mbeti gjithmonë kritik kundrejt mekanikës kuantike, disiplina që edhe sot ofron përshkrimin më të saktë të fenomeneve fizikë në shkallën atomike dhe nënatomike. Që nga 1922 e deri në fund të jetës ai ndoqi një projekt shumë ambicioz: të ndërtonte një teori edhe më të përgjithshme të relativitetit të tij, që mundësisht të shpjegonte përsenë e ekzistencës së ngarkesave elektrike dhe që ndoshta do të zgjidhte problemet që linte pas mekanika kuantike. Por nuk ia doli asnjëherë, edhe pse në një farë kuptimi hapi rrugën për zhvillimin e fizikës në vitet që do të vinin.

Akuza komplotizmi

Në 1 tetor 1940 Albert Einstein u bë nënshtetas amerikan. Një vit më herët i kishte shkruajtur një letër presidentit të atëhershëm të SHBA, Franklin Delano Roosevelt, për ta informuar për rrezikun që Gjermania hitleriane mund të ndërtonte një bombë atomike dhe për të marrë pra, mbështetjen e tij politike dhe financiare për realizimin e një nisme të ngjashme amerikane me qëllim parandalues. E firmosur në 2 gusht 1939, letra i shkoi Rooseveltit në 3 tetor: Lufta e Dytë Botërore kish një muaj që kish shpërthyer. Në vijim, Albert nuk pati asnjë rol në Projektin Manhattan për ndërtimin e bombës atomike,

por vetëdija e tij pacifiste ishte trazuar nga rreziku nazist. Në vitin 1943 u zgjodh konsulent në marinën amerikane, në seksionin e eksplozivëve dhe municioneve, dhe në vitin 1944 rishkroi me dorë artikullin e 1905 mbi relativitetin, që kish dalë në ankand për 6 milionë dollarë si kontribut kundër luftës. Në dekadën e parë pas luftës, Albert Einstein vazhdoi të bëjë të dëgjohej zëri i tij në shumë tema politike. Në një letër të hapur drejtuar Kombeve të Bashkuara e datës 1946, kërkoi formimin e një qeverie botërore, ndërsa në 1952 iu ofrua presidenca e Izraelit, që e refuzoi. Një vit më vonë iu kundërvu të ashtuquajturit makartizëm, fushatës antikomuniste të asaj kohe në SHBA që erdhi si nismë e senatorit Joseph McCarthy. E pashmangshme, ai vet u dyshua për komunizëm. Në të vërtetë, Einstein ishte një mbrojtës i lirive individuale dhe institucioneve demokratike, dhe urrente tiraninë e sistemit sovjetik. Aq sa nuk pranoi asnjëherë ftesa të shumta për të vizituar BRSS. Në 11 prill 1955 Einstein firmosi një manifest pacifist të redaktuar nga matematicieni dhe filozofi britanik Bertrand Russell, ku ftoheshin të gjithë shtetet që të hiqnin dorë nga armët bërthamore. Ai ishte akti i tij i fundit publik. Ndërroi jetë në spitalin e Princeton pikërisht një javë më vonë, në moshën 76 vjeçare. Sipas amanetit të tij, trupi u dogj dhe hiri u shpërnda në një vend të fshehtë. Për të vazhdohej të flitet me pasion edhe sot. Aq sa, si dëshmi e popullaritetit të tij të paperëndueshëm, në dhjetor 1999 Einstein u kurorëzua “njeriu i shekullit XX” nga e përjavshmja Time, për të nderuar “profesorin e sjellshëm, fytyra e të cilit u bë simbol dhe emri i të cilit u bë sinonim i gjenit”. / Bota.al





Goditje për Kosovën dhe Napolin, Rrahmani dy muaj jashtë fushës

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kombëtarja e Kosovës në futboll do të jetë pa kapitenin Amir Rrahmani për ndeshjen me Sllovakinë që zhvillohet në fund të muajit të ardhshëm në kuadër të “play-off”-it për Botërorin 2026. Rrahmani nuk do të jetë në gjendje të rikthehet në fushë deri në

fund të muajit prill, pasi është i detyruar të pushojë të paktën dy muaj. Kështu kanë raportuar mediet italiane të mërkurën për Rrahmanin, i cili veçse ka filluar fazën e rehabilitimit. Lëndimi i Rrahmanit është serioz, të cilin e pësoi në ndeshjen kundër Romës, ndërsa ka

pësuar një këputje në kofshën e këmbës së majtë. “Rrahmani nuk ka gjasa të rikthehet para fundit të prillit, ndoshta edhe në fund të sezonit, ta rikuperojë formën dhe gjendjen e tij fizike”, kanë raportuar mediet në Itali. Ky është lëndimi i tretë i Rrahmanit këtë sezon pas atij

në fillim të muajit shtator të vitit të shkuar dhe në fund të janarit të këtij viti, shkaku i të cilave 31-vjeçari ka humbur në total 12 ndeshje në të gjitha garat me Napolin. Deri më tani Rrahmani ka regjistruar 22 paraqitje me Napolin në të gjitha garat, ku ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 1 asistim.



UEFA CAKTON GJYQTARË ANGLEZË PËR DUELIN DRITA - CELJE

PRISHTINË, 18 SHKURT - UEFA ka caktuar edhe gjyqtarët që do ta ndajnë drejtësinë në ndeshjen Drita - Celje, e cila i takon fazës “play-off” të Ligës së Konferencës. Dueli Drita - Celje zhvillohet sonte (e enjte) prej orës 21:00 në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, me

kampionen e Kosovës që kërkon rezultat pozitiv para duelit të kthimit javën tjetër në Slloveni. Gjyqtar kryesor i këtij takimi do të jetë Chris Kavanagh, i cili do të ndihmohet nga Simon Bennet si asistent i parë dhe Neil Davies, që do të jetë asistenti i dytë. Arbitri i katërt do të jetë Thomas

Bramall, kurse në VAR është Darren England, që do të ndihmohet nga Peter Bankes në AVAR. Drita ka arritur ta kalojë me sukses fazën e ligës të Ligës së Konferencës, ku në gjashtë ndeshje të luajtura ka regjistruar dy fitore, dy barazime dhe po aq humbje.

ILIEVSKI I PRISHTINËS SHPALLET “YLLI I JAVËS” NË SUPERLIGË

Prishtinë, 18 shkurt - Sulmuesit të skuadrës së Prishtinës, Mario Ilievskit, i ka takuar epiteti i futbollistit më të mirë për xhiron e fundit në Superligën e Kosovës.

Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) të mërkurën ka njoftuar se Ilievski është shpallur “Ylli i Javës” për xhiron e 20, në të cilën pati paraqitje fantastike. Ilievski ka shënuar dy gola në fitoren bindëse të Prishtinës 4:2 në ndeshjen derbi kundër Llapit, duke u konfirmuar lojtari më i mirë i javës nga Komisioni i Veteranëve të futbollit, i cili bën edhe vlerësimin. Pasi ka marrë çmimin “Ylli i Javës”, Ilievski është shprehur tejet i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës, duke shtuar se Prishtina

nuk do të dorëzohet, por do të luftojë deri në fund për kreun e tabelës. “Është kënaqësi të zgjidhesh lojtari më i mirë i javës. Ky është një motiv shtesë për mua, por edhe për tërë ekipin. Pas ndeshjes me Ballkanin erdhëm të mërzitur, por penalltitë janë gjithmonë çështje fati. Prishtina është klubi më i madh në Kosovë dhe një emër shumë i madh në të gjithë rajonin e Ballkanit, andaj do të luftojmë për kreun e tabelës, sidomos tani me trajnerin e ri, me të cilin po i përgatisim ndeshjet shumë mirë”, ka thënë Ilievski për faqen zyrtare të FFK-së. Prishtina zë vendin e dytë në Superligë me 36 pikë, sa i ka edhe Ballkani që është lider pas 20 javëve të luajtura.



UEFA nis hetimet për rastin e Vinicius Jr, akuza për sjellje diskriminuese

Nyon, 18 shtator - UEFA e ka hapur zyrtarisht një hetim disiplinor pas akuzave për sjellje diskriminuese të raportuara gjatë ndeshjes së Champions League në mes të Benficas dhe Real Madridit. Episodi ka të bëjë me sulmuesin brazilian Vinicius Junior, i cili

pretendon se është përballur me komente të papërshtatshme me natyrë diskriminuese gjatë takimit. Sipas raportimeve, incidenti ndodhi pas një momenti tensioni në fushë, ndërsa lojtari reagoi menjëherë duke e njoftuar gjyqtarin. Pas përfundimit të ndeshjes,

UEFA ka konfirmuar se e ka emëruar një Inspektor të Çështjeve Etike dhe Disiplinore për t'i analizuar raportet zyrtare, pamjet filmike dhe çdo provë tjetër relevante për rastin. Benfica e ka mohuar kategorikisht çdo akuzë për sjellje raciste, duke theksuar

se bëhet fjalë për një keqkuptim gjatë një momenti të tensionuar loje. Rasti e ka rikthyer edhe një herë në qendër të vëmendjes çështjen e racizmit në futbollin evropian, ndërsa vendimi përfundimtar i UEFA-s pritet pas përfundimit të hetimeve.



Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin "MIRECO" Sh.p.k. Lëbushë, Deçan, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/5799/MMPHI/461/DMM, për veprimtarinë: Impianti për mbledhjen, grumbullimin, klasifikimin, rikuperimin, thërmimin-thyerjen, paketimin dhe magazinim të mbetjeve të tullave zjarrduruese (refraktare), zona industriale Mitrovicë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 19.03.2026, në ora: 14:00, në hapësirat e Palace Hotel, Shupkovc, Mitorvicë do të organizohet debat publik nga operatori "MIRECO" Sh.p.k. Lëbushë, Deçan, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/5799/MMPHI/461/DMM, për veprimtarinë: Impianti për mbledhjen, grumbullimin, klasifikimin, rikuperimin, thërmimin-thyerjen, paketimin dhe magazinim të mbetjeve të tullave zjarrdruese (refraktare), zona industriale Mitrovicë,, me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>
Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=Mireco>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"MIRECO" Sh.p.k.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kesency” L.L.C. pronar Fatmir Tahiri me seli në Gjiilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811954959 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Per Ty Media" L.L.C. Fatmir Tahiri Gnjilane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811954959 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Per Ty Media” L.L.C. with owner Fatmir Tahiri with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811954959 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Princesha-Bani-Com" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810962416.
- Arben Rama shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Rifat Plava shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Ali M Hasi" Cërmjan Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Bekim Brahimaj shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Kreshnik Kusari B.I. shpall të pavlefshme nr. Certifikatën e biznesit 810110289 të lëshuar nga MTI e Kosovës.
- Kristjan Luli shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- D.P.Z. "Ylli" shpall të pavlefshme numrin e biznesit 70683016 të lëshuar nga MTI e Kosovës.
- Andi Rezniqu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmua "Shaban Golaj" Lipovec Gjakovë.
- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjmnazit "Gjon Buzuku" Prizren.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

